



Shkolla Franceze Ndërkombëtare e Tiranës

Rregullorja e brendshme e kolegjit

Shkolla Ndërkombëtare Franceze e Tiranës është një shkollë partnere e Agjencisë për Mësimdhënie e frengjishtes jashtë vendit (AEFE). EFIT duhet t'u mundësojë të gjithë atyre që e frekuentojne, cilado qofte natyra e punës të tyre, të punojnë dhe të jetojnë në kushtet më të mira të mundshme.

Rregullorja e brendshme përfaqëson tërësinë e rregullave të jetesës, detyrimeve, të drejtave dhe detyrave të të gjithë komunitetit arsimor të institucionit. Ky komunitet bashkon nxënësit dhe të gjithë ata që kanë lidhje të drejtpërdrejta ose jo të drejtpërdrejta me të, e që marrin pjesë në formimin e tij, ku përfshihen:

- personeli, cilido qoftë funksioni, statusi dhe gradën e tij;
- prindërit e nxënësve;
- partnerët e shkolles

Rregullorja e brendshme është në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet e Republikës Franceze, dhe Deklaratën e të Drejtave të Njeriut dhe Qytetarit dhe Deklaratën si edhe Deklaratën e të Drejtave të Fëmijëve. Ajo bazohet në respektimin e vlerave dhe parimeve të arsimit kombëtar francez: paanshmërisë dhe laicitetit, barazisë gjinore dhe mundësive të barabarta në trajtimin e vajzave dhe djemve, garancisë për mbrojtje nga të gjitha format e dhunës psikologjike, fizike apo morale si edhe detyrimin si rrjedhojë për të mos dhunuar.

Rregullorja e brendshme, e miratuar nga Këshilli i Shkollës, përcakton mënyrat e funksionimit specifike për institucionin. Ajo duhet të zbatohet nga të gjithë, brenda strukturës shkollore dhe gjatë të gjitha aktiviteteve në të cilat nxënësi merr pjesë, duke përfshirë edhe aktivitetet jashtëshkollore, daljet dhe udhëtimet shkollore. Transporti është objekt i një rregulloreje të veçantë.

Ajo duhet t'u mundësojë të gjithëve të jetojnë dhe punojnë në harmoni dhe të punojnë së bashku për suksesin e secilit prej nxënësve duke i udhëhequr dhe shoqëruar ata përmes punës së efektshme në ekip në dobi të të gjithëve. Cdo anëtar i komunitetit të shkollës duhet të sigurojë zbatimin e kësaj rregulloreje.

1) Organizimi i vitit shkollor

a) Kalendari

Kalendari shkollor përditesohet çdo vit. Ai aprovohet nga Këshilltari për Bashkëpunim dhe Veprim Kulturor i Ambasadës Franceze në Shqipëri dhe nga Inspektori i Arsimit Kombëtar Francez (IEN në Romë). Mund të bëhen ndryshime në varësi të festave kombëtare të vendit pritës.



Ecole Française Internationale de Tirana Shkolla Franceze Nderkombetare e Tiranës

b) Oraret dhe pritja

Orari i hyrjes dhe daljes

	E HENE	E MARTE	E MERKURE	E ENJTE	E PREMTE
ORARI	08H30 – 15H30	08H30 – 15H30	08H30 – 15H30	08H30 – 15H30	08H30 – 12H30

Në kolegji (9-vjeçare) nxënësit arrijnë në oborrin e shkollës, ku do të priten nga mësuesit që janë në shërbim duke nisur nga ora 8:20. Nxënësit që mbërrijnë në shkollë para orës 8:20 do të drejtohen për nga kujdestaria ku do të priten nga personeli që merret me mbikëqyrjen.

Në fund të orës së mësimit, nxënësit e shkollës u dorezohen prindërve të tyre në sallën e hyrjes në zonën e rezervuar. Fëmijët që marrin autobusin dhe taksinë mblidhen në pjesën tjetër të sallës.

Cdo vonese e rëndësishme duhet t'i raportohet sekretarisë së shkollës. Nxënësit që janë me vonesë shoqerohen nëpër klasat përkatëse nga stafi i shkollës.

Cdo lëvizje e personave të huaj për shkollën është e ndaluar gjatë orarit mësimor, përveç dispozitave të veçanta. Kushdo që dëshiron të hyjë brenda ambienteve të shkollës, i kërkohet të njoftojë në sekretari (telefon, interfon).

c) Kujdestaria

Në mëngjes dhe pasdite ofrohet shërbimi i kujdestarisë. Nxënësit që mbërrijnë midis orës 8:00 dhe 8:20 të mëngjesit, priten nga stafi i shkollës përgjegjës për kujdesin ditor. Pas daljes, nxënësit që nuk janë larguar ende shkojnë në kujdesin ditor nën mbikëqyrjen e një ASEM (ndihmës-edukatore). Kujdestaria e pasdites është e hapur nga ora 15:30 deri në ora 17:00 (15:30-16:30 te premtëve)..

Për të lehtësuar menaxhimin e lëvizjeve dhe për arsye përgjegjësie, prindërit dhe personat e autorizuar për marrjen e fëmijëve nuk lejohen të qëndrojnë në oborr ose të përdorin pajisje shkollore (kend lojrash, topa apo lojëra të tjera) pas marrjes së fëmijës së tyre apo gjatë pritjes së mëngjesit.

d) Pushimet dhe ditët festive:

Për vitin shkollor 2019/2020, pushimet shkollore të EFIT janë:

Pushimet e vjeshtës	Nga 19 tetori deri me 03 nëntor 2019
Pushimet e Krishtlindjes	Nga 21 dhjetori 2019 deri me 05 janar 2020
Pushimet e shkurtit	Nga 22 shkurti deri me 08 mars 2020
Pushimet e Pashkëve	Nga 25 prilli deri me 10 maj



Pushimet e verës	Nga 04 korriku deri me 02 shtator 2020 (02 shtatori mbetet për t'u konfirmuar)
------------------	--

Ditët e pushimit të EFIT: e enjte 28 dhe e premte 29 nëntor 2019, e hënë 13 prill 2020

e) Vlerësimi i kompetencave

Nxënësit ndjekin një program të provimeve të imponuara nga CNED. Kopjet e tyre dërgohen në Francë në format elektronik, ku korrigjohen nga mësuesit e Arsimit Kombëtar. Studentët informohen më pas për notat e tyre përmes mësuesve. Vlerësimet e mësuesve raportohen në buletin të secilit student. Ato u jepen prindërve përmes fëmijës së tyre.

Kalimi në vitin pasues jepet nga CNED nëse nxënësi ka kryer një numër minimal detyrash në secilin lëndë.

f) Komunikimi midis prindërve dhe mësuesve

Nëse prindërit dëshirojnë një takim, mësuesit dhe drejtori janë të disponueshëm jashtë orarit të shkollës. Mbledhja e fillimit të vitit shkollor organizohet në shtator.

Këshilli i shkolles mbahet çdo tre muaj. Raporti u dërgohet të gjitha familjeve, postit diplomatik dhe IEN.

Komunikimi me email do të jetë mjeti i preferuar i komunikimit ndërmjet shkollës dhe prindërve.

Ekzistojne tre adresa email-i :

efit.tirana@gmail.com: kontakti i drejtorisë administrative (Marsida Sula dhe Anisa Okayay)

info@efit.edu.al: kontakti i drejtorisë pedagogjike (Arnaud Jaffrézo)

efitcnedcollege@gmail.com: kontakti i koordinimit të kolegjit

Në formë të printuar do t'ju vihen në dispozicion disa dokumenta administrative të caktuara.

Gjatë vitit shkollor do të ketë dy mbledhje mes prindërve dhe mësuesve (fund dhjetori dhe fund qersori).

Kurdo që të jetë e nevojshme, mësuesit do të kontaktojnë prindërit. Prindërit gjithashtu do të mund të kërkojnë një takim me një mësues përmes fletore të korrespondencës të fëmijës së tyre ose me email në adresën e tyre profesionale

2.Frekuentimi

Frekuentimi i shkollës është i detyrueshëm. Cdo mungesë duhet të raportohet që në ditën e parë në sekretariat.

Në rast të semundjeve ngjitëse prindërit duhet të dorëzojnë një dokument mjekësor që siguron mos ngjitjen. Të njoftohet shkolla menjëherë në rast të ndonjë sëmundjeje ngjitëse si fruthi, shytat, rubeola etj.

Për nxënësit francezë, në rast mungese të rëndësishme , shkolla duhet të vërë në dijeni ambasadën e Francës.



Ecole Française Internationale de Tirana *Shkolla Franceze Nderkombetare e Tiranës*

b) Mungesat

Për cdo mungesë duhet të njoftohet sekretaria.

*Justifikimi i mungesave

Për cdo mungesë të fëmijës njëri prej prindërve duhet të vërë në dijeni sekretarinë e shkollës nëpërmjet telefonit ose e-mail-it.

Çdo përjashtim nga Edukimit Fizik duhet të justifikohet me një certifikatë mjekësore. Sekretaria e shkollës regjistron për secilin nxënës justifikimin e mungesës, nëse është e nevojshme, me një certifikatë mjekësore.

Nëse një nxënës mungon pa arsye, apo pa njoftim të mëparshëm për tri dite rresht, drejtori i shkollës vë në dijeni prindërit nëpërmjet një njoftimi me shkrim.

Kur familjet janë në dijeni paraprakisht për mungesat duhet të njoftojnë mësuesin apo sekretarinë duke shpjeguar dhe arsyet e mungesës.

*Autorizimi i mungesave

Për të marrë leje gjatë orarit të shkollës do të bëhet një kërkesë me shkrim (për një vizitë mjekësore për shembull). Nëse nxënësi duhet të largohet nga klasa për një arsye të caktuar, ky i fundit i dorëzohet vetëm personit të autorizuar. Ky i fundit duhet të paraqitet patjetër pranë sekretarisë së shkollës për të marrë nxënësin.

*Vonesat

Vonesat në shkollë pengojnë mbarëvajtjen e mësimit. Prindërit dhe personat që shoqëronë fëmijët duhet t'i respektojnë oraret e shkollës. Pasi fëmijët ngjiten nëpër klasa, porta e shkollës mbyllet. Fëmijët, të cilët mbërrijnë pas orarit të mbylljes së portës duhet të presin që një anëtar i stafit të shkollës t'i shoqërojë në klasë.

3 Jeta shkollore

a) Lëvizjet dhe zhvendosjet e nxënësve

Të gjithë anëtarët e komunitetit edukues kanë të drejtën dhe detyrën të ndërhyjnë në cdo cast dhe vecanërisht gjatë kohës së pushimit për të mbikëqyrur respektin ndaj mjeteve dhe personave.

* Lëvizjet

Asnjë nxënës nuk duhet të rrijë në klasë pa praninë e një mësuesi apo të qëndrojë nëpër korridore ose në shkallë gjatë pushimit. Lëvizjet brenda hapësirave të shkollës duhet të bëhen me qetësi, rregull dhe nën përgjegjësinë e një të rrituri.



Cdo nxënës që i shmanget me dashje mbikqyrjes ose largohet nga shkolla pa leje do të përballet me sanksione të ashpra.

Në kolegji, nxënësit shkojnë në mënyrë individuale në tualet pasi kanë marrë leje të i rrituri përkatës.

*Pushimi

Pushimet bëhen në oborrin e shkollës sipas orareve të përcaktuara. Janë caste clodhjeje dhe ndërveprimi. Të gjithë nxënësit e kanë të drejtën e pushimit, përvec ndonjë rasti të jashtëzakonshëm. Lojrat duhet të jenë të përshtatshme dhe nuk duhet të rrezikojnë vetë fëmijën ose shokët e tjerë. Lojrat organizohen vetem me materialet që vë në dispozicion shkolla. Cdo lloj dhune fizike apo verbale do të ndëshkohet.

b) Mbikëqyrja

Fëmijët do t'u dorëzohen familjes ose personave të autorizuar prej tyre, me mbarimin e mësimit paradite dhe pasdite, përvec rastit kur merren në ngarkim me kërkesë të familjes, nga një shërbim mbikëqyrjeje ose transporti.

- Në klasë fëmijet janë të mbikëqyrur nga mësuesi përgjegjes i klasës.
- Gjatë pushimit ata janë të mbikëqyrur nga mësuesi i shërbimit.
- Në drekë, ata mbikqyren nga stafi jopedagogjik i shkollës.
- Gjatë kujdestarisë mbikqyren nga stafi ASEM (ndihmës/edukatore) i shkollës.

c) Respektimi i komunitetit arsimor « neni 111-3 Kodi i edukimit »

Mësuesit, pjesa tjetër e stafit të shkollës, prindërit dhe fëmijët duhet të tregojnë respekt të ndërsjellë brenda shkollës. Prindërit e fëmijëve janë anëtarë të komunitetit edukues, roli dhe pozicioni i tyre njihet nga Kodi i Edukimit.

Nxënësit ashtu si edhe familjarët e tyre nuk duhet të lejojnë sjellje, veprime apo fjalë që çenojnë dinjitetin, funksionin apo personin që përfaqëson mësuesi, ashtu si edhe pjesën tjetër të stafit të shkollës. **Cdo kundërshtim me atë që u përmend më sipër do të raportohet (njoftim me shkrim për prindërit, raport për komitetin drejtues dhe\ose ambasadën franceze)**

Për cdo lloj mosrespektimi ndaj rregullores së brendshme sidomos lidhur me integritetin fizik apo moral të nxënësve të tjerë apo personelit të shkollës, mund të bëhet objekt për paralajmërim dhe\ose ndëshkime.

d) Respektimi i laicitetit “ neni 141-5-1 i Kodit të Edukimit

Në përputhje me dispozitat e Kodit të Edukimit, mbajtja e aksesorëve ose veshjeve që tregojnë përkatësi fetare është e ndaluar.

e) Kodi i veshjes

Shkolla është vend publik, i cili kërkon veshje të përshtatshme dhe serioze sipas institucionit. Nëse secili është i lirë për t'u veshur sipas dëshirës, është e rendësishme të mos çenohet ndjeshmeria e të



Ecole Française Internationale de Tirana *Shkolla Franceze Nderkombetare e Tiranës*

tjerëve si edhe te respektohet vendi. Si rrjedhojë, veshja duhet të jetë e përshtatshme, jo provokuese, e pastër, e mirëmbajtur dhe në përputhje me moshën e nxënësit.

Brenda shkollës, duhet të respektohen rregullat e mëposhtme:

- Koka nuk mbulohet brenda ambienteve të shkollës,
- Rrobat nuk janë të grisura, të shpuara ose transparente,
- Veshjet e brendshme, shpina, kraharori dhe kërthiza janë të mbuluara në të gjitha rrethanat dhe në çdo pozicion, në këmbë dhe ulur,
- Rrobat me mbishkrime vulgare, agresive, raciste ose seksiste, si dhe shenjat dhe simbolet politike janë të ndaluara.

Këto rregulla të veshjes janë të vlefshme gjithashtu gjatë ekskursioneve dhe udhëtimeve shkollë. Në rast mosrespektimi të këtyre udhëzimeve, dhe pas një diskutimi paraprak, shkolla ka të drejtë të mos lejojë pjesëmarrjen e nxënësit në fjalë.

Rekomandohet që t'i vendosni një shenjë veshjeve të fëmijëve. Shkolla nuk mban përgjegjësi në rast humbjeje. Veshjet të cilat harrohen në shkollë do të shpërndahen në organizata bamiresie dy herë në vit (në janar dhe korrik)

e) Mensa

1. Vaktet

Gjate pushimit të paradites fëmijët mund të marrin me vete një vakt të lehtë. Ushqimet apo lëngjet duhet të jenë të larmishme, duke i dhënë përparësi ujit, lëngjeve pa sheqer të shtuar, qumshtit ose produkteve të bylmetit gjysëm të skremuara, bukë, drithëra, fruta apo perime. Për sigurinë e fëmijëve, do të ishte e keshillueshme të shmangen mbajteset prej qelqi (përfshirë edhe shishet e ujit).

Vakti i paradites nuk është as sistematik as i detyrueshëm.

Nxënësve u kërkohet të marrin me vete një shishe të cilën mund ta mbushin nëpër makinatat e ujit të vendosura nëpër cdo kat.

2. Mensa

Vaktet e EFIT përgatiten nga KAME RESORT dhe shërbehen në mensën e shkollës. Mensa funksionon nga dita e parë deri në ditën e fundit të shkollës. Organizimi bëhet me dy shërbime : cikli parashkollor dhe klasa e parë në fillim e më pas cikli fillor dhe ai 9-vjecar.

Koha e ngrënies është një moment clodhjeje, për t'u ushqyer por edhe një moment ku mund të bashkëbisedohet me të tjerët, mësohen rregullat e të jetuarit në komunitet, respekti ndaj ushqimit, personelit dhe mjeteve e pajisjeve.

Rregullorja e brendshme zbatohet edhe gjatë orarit të drekës. Nxënësit mbikqyren në mensë nga stafi i shkolles. Ata duhet të jenë të sjellshëm ndaj stafit. Nxënësit që nuk ruajnë disiplinën pavarësisht paralajmërimeve nga stafi mbikqyrës i shkollës, largohen nga shokët e tyre të klasës.



Në rast se situata perseritet, do të njoftohen prindërit nga drejtoria e shkollës dhe nxënësi mund të përjashtohet përkohësisht nga shërbimi i mensës deri në përmirësimin e sjelljes. Në rast dëmtimi apo thyerjeje, koston e paguan familja që ju faturohet nga instiucioni i shkollës. Regjistrimi në shërbimin e mensës nënkupton pranimitim e këtyre kushteve nga ana e prindërve.

3. Dreka me vete

Për fëmijët, të cilët e marrin drekën me vete këshillohet që ajo të vendoset në një cantë frigoriferike që të ruhet deri në vaktin e drekës. Për një higjenë sa më të mirë këshillohet që cantat të mos vendosen në frigorifer. Gotat, lugët, pirunjtë sigurohen nga shkolla.

g) Mjetet shkollore

Çdo ditë, nxënësi duhet të ketë me vete të gjitha pajisjet e nevojshme për të punuar gjatë ditës, detyrat e shtëpisë të bëra, mësimet e mësuara. Fletoret ose dosjet duhet të mirëmbahen, të jenë të përditësuara dhe mund të kontrollohen nga mësuesit. Nxënësit janë përgjegjës për materialin shkollor që u shpërndahet në fillim të vitit shkollor (fletore, stilolapsa, gomë ...) dhe do të duhet të marrin përsipër zëvendësimin në rast të humbjes ose dëmtimit.

Materiali shkollor duhet të respektohet. Dëmtimi me qëllim nga nxënësit mund të çojë në dëmshpërblim dhe ndëshkim. Një kompensim financiar mund të kërkohet nga familjet.

Degradimi vullnetar është një akt vandalizmi dhe si i tillë dënohet me ndëshkim, pavarësisht nga kompensimi monetar për dëmin.

h) Përdorimi i mjeteve të caktuara personale :

Rikujtojmë se lejohet përdorimi vetëm i mjeteve të cilat janë të nevojshme për shkollën. **Përdorimi i telefonave celularë apo ndonje mjeti tjetër komunikmi është i ndaluar brenda ambjenteve të shkollës (brenda në shkollë, në oborr...).**

Nëse nuk zbatohet ky rregull, nxënësi do të duhet ta fikë dhe ta dorëzojë aparatën pranë drejtorisë së shkollës.

Depozitimi i telefonit dhe kthimi i tij do të mbahen shënim në një regjistër përkatës.

Në rast nevoje, nxënësit mund të komunikojnë me prindërit me anë të telefonit të sekretarisë, të mbikëqyrur nga një i rritur i shkollës.

Duhet theksuar se përdorimi i njërës prej këtyre pajisjeve për të regjistruar, për të filmuar dhe për të shpërndarë imazhe pa autorizim dhe/ose që prek dinjitetin dhe të drejtën e ruajtjes së imazhit të tyre te njerëzit është një gabim i rëndë dhe do të sanksionohet si i tillë.

Në kontekstin e aktiviteteve specifike pedagogjike dhe të mbikëqyrura, përdorimi i një pajisjeje celulare duhet të ketë autorizimin e mësuesit në fjalë.



Ecole Française Internationale de Tirana *Shkolla Franceze Nderkombetare e Tiranës*

i) Funksionimi i bibliotekës

Biblioteka mbledh së bashku në një ambient burimet e materialeve të nevojshme për arritjet shkollore të nxënësve. Rregullorja e brendshme është e vlefshme edhe në bibliotekë, por disa rregulla specifike të funksionimit që u drejtohen përdoruesve të saj janë të afishuara në hyrje të bibliotekës (oraret, e drejta për të huazuar ...) dhe të saktësuara në rregulloren e bibliotekës. Cdo libër i humbur apo i dëmtuar duhet të zëvendësohet ose rimbursohet nga familja.

4) Higjiena dhe siguria

a) Higjiena e mjediseve :

Secili kujdeset për pastërtinë e institucionit dhe për respektimin e rregullave të përdorimit të secilit prej ambienteve, vecanerisht të sanitareve. Nxënësit duhet të vëzhgojnë rregullat e higjienës në përshtatje me frekuentimin e mjedisit të destinuar për edukim.

Konsumi i çimcakëzëve ose ushqimit është i ndaluar në klasë. Koshat e plehrave të vendosur nëpër klasa si edhe në mjedise të tjera (oborr, korridore...) shërbejnë për hedhjen e të gjitha letrave dhe mbeturinave të tjera.

Kafshët që mund të futen pa rrezik në ambientet e shkollës në kuadër të projekteve pedagogjike duhet të jenë në gjendje të mirë shëndetësore. Mësuesit sigurohen paraprakisht që prania e tyre nuk çënon shëndetin e ndonjërit prej nxënësve (alegji nga qimet e kafshëve, pendët...) Kafshët e tjera shtëpiake nuk mund të hyjnë në ambientet e shkollës dhe duhet të mbahen të lidhura jashtë saj.

b) Higjiena dhe shëndeti i fëmijëve

Një nxënës që sillet në shkollë nga një i rritur përgjegjës për kujdesin e tij dhe që duket qartazi që është i sëmurë nuk do të pranohet në shkollë. Në rast të një nxënësi që ka parazitë, drejtorja do t'i kërkojë familjes të marrë masa për të mos cënuar jetën kolektive. Shkolla do të njoftojë cdo familje në mënyrë që të merren masat e përshtatshme. Nëse një familje konstaton një parazit është e lutur të vërë në dijeni shkollën.

Mësuesit dhe personeli i ndihmës/edukatoreve nuk janë të autorizuar të japin barna fëmijëve përveç kuadrit të një projekti pritjeje të personalisuar (PAI) ose me kërkesë me shkrim të prindërve dhe pranisë së recetës mjekësore përkatëse.

Asnjë medikament nuk duhet të lihet në zotërimin e nxënësit

c) Higjiena dhe siguria e ushqimeve :

Karamelet dhe çimcakizët janë të ndaluar brenda ambienteve të shkollës.

a) Siguria e nxënësve :

Prindërit janë të lutur të plotësojnë më saktësi të gjithë dokumentacionin e dhënë në fillim të cdo viti shkollor. Ai duhet t'u kthehet sa më shpejt mësuesve i firmosur . Në këto dokumenta duhet të figurojnë:



- të dhënat e përditësuar ku mund të kontaktohen prindërit
- të dhënat e përditësuar të përsosave të autorizuar për të marrë nxënësin nga shkolla.

Prindërit duhet të njoftojnë menjëherë për cdo ndryshim ; adrese apo telefoni.

Sigurimi shkollor individual është i detyrueshëm.

Një nxënës, i cili herë pas here i nënshtrohet kujdesit ose seancave të riedukimit gjatë shkollës, mund të largohet nga shkolla vetëm nëse shoqërohet nga një person i autorizuar, me kërkesë me shkrim nga prindërit. Fëmija atëherë është nën përgjegjësinë e prindërve të tij.

Nëse një nxënës nuk ndihet mirë, është helmuar, ose ka pësuar aksident, shkolla njofton familjen sa më shpejt të jetë e mundur në mënyrë që të vijnë ta marrin. Në raste më të rënda, shkolla njofton menjëherë shërbimet e urgjencës dhe lajmëron familjen.

Në shkollë është e ndaluar futja e sendeve të rrezikshme ose me vlerë (sende të forta ose prerëse, gjilpërëkapëse, çakmake, shkrepëse, videolojra etj...)

Shkolla ka të drejtë të ndalojë futjen e cdo sendi që e konsideron të rrezikshëm në ambjentet e saj.

Mbajtja e bizhuterive ose sendeve të tjera me vlerë nuk këshillohet. Shkolla nuk mban asnjë përgjegjësi në rast humbjeje, vjedhjeje apo dëmtimi.

Është rreptësisht i ndaluar konsumi i duhanit brenda ambjenteve të shkollës.

4) DISIPLINA : Dënimet dhe sanksionet

Cdo shkelje e Rregullores së brendshme justifikon zbatimin e një procedure disiplinore specifike në shkollë dhe në fushën e arsimit. Kështu vendoset një sistem progresiv i penalizimit, i cili synon ta bëjë nxënësin të kuptojë se ai duhet të adoptojë sjellje që janë në përputhje me kërkesat e punës së tij individuale dhe të jetës kolektive. Kjo do të lehtësojë mësimin e autonomisë.

Ndëshkimet dhe sanksionet, të motivuara dhe të shpjeguara, përmbajnë vlera arsimore, respekt për personin e nxënësit dhe dinjitetin. Proçedura duhet të garantojë parimin e kundërshtimit. Bazuar në seriozitetin e shkeljes, ato janë individuale, proporcionale me fajin e kryer, marrin parasysh personalitetin e nxënësit dhe çdo rrethanë të veçantë.

A- Ndëshkimet

Ndëshkimet në shkollë kryesisht kanë të bëjnë me shqetësime "të vogla" në jetën e klasës ose shkollës. Ato gjithashtu kanë të bëjnë me kundërshtimin e qëllimshëm dhe refuzimin për të punuar. Dënimet mund të jepen nga personeli drejtues, nga stafi edukues, mësimor dhe me propozimin e një anëtari tjetër të komunitetit arsimor.

Ka pesë lloje ndëshkimesh :

1) shënimi në fletoren e korrespondencës për të informuar prindërit, të cilët duhet ta nënshkruajnë shënimin (tre shënime në fletoren e korrespondencës gjatë një tremujori do të sjellin një dënim).



Ecole Française Internationale de Tirana *Shkolla Franceze Nderkombetare e Tiranës*

- 2) kërkimi i faljes me gojë ose me shkrim
- 3) detyra shtesë
- 4) kufizime
- 5) përjashtimi nga një orë mësimore, shoqëruar me një detyrë për tu bërë dhe një raport incidenti (qarkulluesi Nr. 2000 - 105, datë 11 korrik 2000). Nxënësi i përjashtuar shoqërohet në zyrën e administrimit nga nxënësi i shërbimit. Ai pastaj është nën përgjegjësinë e drejtorisë administrative dhe duhet të ketë një punë për të bërë.

Mbajtje pas mësimit të disa llojeve mund të propozohen:

Mbajtje pas mësimit me punë shtesë për të bërë. Këto orë pas mësimit do të zhvillohen të premteve pasdite nga ora 13:30 deri në 15:30, një orë ose dy orë në varësi të seriozitetit të fajit. Mbajtje në klasë, mbikëqyrur nga një mësues gjatë një ore mësimi të tij me një punë ose një detyrë shtesë për të kryer me klasën prezente.

Cdo ndëshkim mund të propozohet nga mësuesit ose nga drejtori i shkollës.

B- Sanksionet

Sanksionet disiplinore kanë të bëjnë me sulmet ndaj personave dhe pronave, si dhe shkelje serioze të detyrimeve të nxënësve.

Sanksionet janë pesë në numër dhe regjistrohen në dosjen shkollore të nxënësit. Ato fshihen në fund të vitit shkollor ose të studimeve ose sipas kërkesës nëse nxënësi ndërron shkollë.

- 1) Paralajmërimi me shkrim (pune ose sjelljeje)
- 2) Qortimi
- 3) Përjashtimi i përkohshëm nga klasa (deri në tetë ditë) me detyrimin për tu paraqitur në shkollë. Atij i jepet punë shtesë, nën mbikëqyrjen e një të rrituri të institucionit. Kjo masë synon të lejojë vazhdimësinë mësimore, duke njohur fajin e kryer dhe përgjegjshmërinë e nxënësit.
- 4) Përjashtimi i përkohshëm (deri në tetë ditë) nga shkolla ose nga një prej shërbimeve të saj shtesë
- 5) Përjashtimi i përhershëm nga shkolla ose nga ndonjë prej shërbimeve të saj shtesë

Drejtori i shkollës mund të japë vetëm sanksionet nga 1 deri në 4. Përjashtimi përfundimtar është në kompetencën e komitetit disiplinor, një e treta e përbërjes së drejtimit (drejtorit të shkollës, COCAC), një e treta e personelit, një e treta e përdoruesve (një prind, një student).



Cdo sanksion i dhënë është rast për një takim midis ekipit drejtues, familjes dhe nxënësit, në mënyrë që të kthehemi në faktet e inkriminuara dhe të shpjegojmë fushën e edukimit të sanksionit.

Sanksionet janë individuale dhe nuk munden, në asnjë rast, të jenë kolektive. Ato mund të shoqërohen me një pezullim të plotë ose të pjesshëm. Kur jepet nje paralajmërimi sanksion nuk aplikohet. Sanksioni do të ekzekutohet vetëm në rast mosrespektimi të mëtejshëm të rregullores.